



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KESHILLI

Nr. 2345/9 prot.

Pogradec, më 26 .06 2025

VENDIM  
Nr. 59, DATË 25 /06 /2025

**PER MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR NGRITJE FIDANIShte, TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 20400 M2 (NJEZET MIJË E KATERQIND ) M2.**

8. Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.816, datë 04.06.2008 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore pyje e kullota në Komunën Çërravë, të Qarkut të Korçës", i ndryshuar me VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr.433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish – Komunave /Bashkive", si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, Udhëzimi nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtarie ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", me propozim të Kryetarit të Bashkisë,, Këshilli Bashkiak:

**VENDOSI:**

9. Të miratojë në parim dhënie me qira, për shesh për ngritje fidanishte, për pasurinë e ndodhur në fshatin Grabovice, Njësia Administrative Çërravë, Bashkia Pogradec, me të dhënat si më poshtë:

| Nr | Z.K  | Pasuria | Vëndodhja          | Siperf në m2 | Objekti kërkeses   |
|----|------|---------|--------------------|--------------|--------------------|
| 1  | 1832 | 272     | Grabovicë, Çërravë | 20400        | Ngritje fidanishte |



10. Afati i dhenies me qera te jete deri ne 10 vite, me te drejte ripertëritje, sipas periudhes te percaktuar ne projektin teknik, të hartuar nga kërkuesit në konkurim.
11. Ne referim te bazes ligjore te sipercituar, ky proces te kryhet sipas percaktimeve te Udhëzimi nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtarive ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore "
12. Tarifat për dhënien me qera të kesaj pasuri, të aplikohen sipas pikes "1", te shtojces nr 1 të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien ne Shfrytezim/ perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.
13. Ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Pogradec për ndjekjen e procedurave ligjore dhe për zbatimin e këtij vendimi.
14. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT  
Manjola KAMOLLI



- 1.Miratuar me 20 vota
- 2.Vota Pro 20
- 3.Vota Kundër 0
- 4.Vota Abstenim 0
- 5.Zbardhur më date 26-06-2025